



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.213, Datë 15.10.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHTATOR 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e bordit nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 133/5 prot., datë 13.10.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Shtator 2021”,

Konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) me shkresën e saj nr. 8338 prot., datë 07.10.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Shtator 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.
- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e

konsideruara nga ERE për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Shtator 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

<i>Çmimi i FMF-së për muajin Shtator 2021</i>				
Shtator 2021			Sipas aplikimit të FSHU sh.a.	Sipas Përlllogaritjeve të ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	20.10	20.10
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.60</u>	<u>0.60</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhen relevante	Leke/kWh	20.70	20.70
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	24.74	24.74

- Bazuar në çdo element të formulës përlllogaritëse bazuar në të dhënat e paraqitura në aplikim rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Shtator 2021, të jetë 24.74 Lekë/kWh.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 24.74 Lekë/kWh për muajin Shtator 2021.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI